



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE

SPITALI UNIVERSITAR I TRAUMËS

Nr. 1645/Prot.Datë, 29. 7. 2021**DREJTUAR:** Qendra "Res Publika"*Adresa: Bulevardi Gjergj Fishta, Nd. 24, H 3, Ap. 7, Tiranë, Shqipëri***LËNDA:** Kthim përgjigje.

Bazuar në shkresën tuaj dërguar në zyrën e protokollit të Spitalit Universitar të Traumës të protokolluar me Nr. 1645 datë 29.07.2021, ku kërkohet informacion i detajuar në lidhje me furnizimin me oksigjen mjekësor, ju informojmë si më poshtë:

Informacioni i kërkuar në pikën 1,2, dhe pikën 3 të shkresës tuaj është i përmbledhur në tabelën si më poshtë:

Te dhenat	2019	2020	6-m 2021	Total
Paciente te shtruar	9339	8741	5166	23246
Paciente qe kane pasur nevojë per O2 mjekësor*	53385	57762	30271	141418
Operacione te kryera	6135	7260	4197	17592

*Për numrin e pacientëve të infektuar me Covid 19, që kanë pasur nevojë për oksigjen mjekësor duhet të drejtoheni pranë spitaleve Covid, pasi rastet e konstatuara me Covid në SUT janë adresuar menjëherë për trajtim drejt spitaleve të miratuara për të qenë Covid nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Përsa i përket procedurave të prokurimit për furnizimin me oksigjen mjekësor, ju informojmë se procedurat e prokurimit zhvillohen në mënyrë të përqëndruar pranë MSHMS si Organ Qëndror Blerës dhe përgjatë periudhës 2019-2021 SUT nuk ka zhvilluar asnjë procedurë prokurimi. Dokumentacionit që përmban procedura e prokurimit nuk ndodhet pranë zyrave të SUT pasi këto dokumenta janë pjesë e dosjes së prokurimit dhe ndodhen në zyrat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si Organ Qëndror i cili ka zhvilluar procedurat e prokurimit me kërkesë të SUT.

Për më tepër, SUT mund t'ju informojë mbi kërkesat që kemi dërguar për prokurim të përqëndruar pranë MSHMS dhe totalin e litrave të kërkuara për periudhën 2019-2021.

Për sa më sipër ju informojmë se, përgjatë vitit 2019-2020, SUT ka bërë kërkesë dhe ka lidhur kontrata, sipas Marrveshjeve kuadër (me afat 12 mujor) të nënshkruara ndërmjet operatorëve të shpallur fitues dhe

MSHMS, në një total prej 90,000 litra oksigjen mjeksor lëng dhe 2,500 litra oksigjen të gaztë me bombula.

Për periudhën 2020-2022, SUT ka bërë kërkesë dhe ka lidhur kontrata, sipas Marrveshjeve kuadër (me afat 24 mujor) të nënshkruara ndërmjet operatorëve të shpallur fitues dhe MSHMS, në një total prej 180,000 litra oksigjen mjeksor lëng dhe 4,000 litra oksigjen të gaztë me bombula.

Marrveshjet kuadër me afat 24 mujor të lidhura nga MSHMS në vitin 2020 janë në proces dhe furnizimi me oksigjen vazhdon sipas kontratave dhe sasisive të parashikuara në këto marrveshje kuadër.

Megjithëse vërehet një rritje e konsumit të oksigjenit mjeksor, e cila nuk ishte e parashikuar, SUT ka vënë në dijeni Organin Qëndror Blerës MSHMS për marjen e masave dhe për prokurimin e oksigjenit dhe të gjitha barnave dhe materialeve mjeksore për të cilat kanë nevojë shërbimet mjeksore në SUT.

3. Përsa i përket kërkesës tuaj për kontratat e furnizimit me oksigjen, ju bëjmë me dije se mund të bëjmë publike, për cdo të interesuar, dokumentacionin i cili nuk bie ndesh sipas kufizimeve ligjore si më poshtë:

LIGJI Nr. 119/2014 "PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT", Neni 3 "E drejta e informimit", pika 4: *Informacioni publik që i është dhënë një personi, nuk mund t'i refuzohet asnjë personi tjetër që e kërkon atë, me përjashtim të rastit kur informacioni përmban të dhëna personale të subjektit, në përputhje me nenin 17 të këtij ligji;*

KUFIZIMI I SË DREJTËS PËR INFORMIM

Neni 17 "Kufizime", pika 1:

E drejta e informimit mund të kufizohet në rast se është e domosdoshme, proporcionale dhe nëse dhënia e informacionit dëmton interesat e mëposhtëm:

a) të drejtën për një jetë private;

b) sekretin tregtar;

c) të drejtën e autorit; ç) patentat.

Kufizimi i së drejtës së informimit, për shkak të interesave të parashikuar në shkronjat "a", "b",

"c" dhe "ç", të kësaj pike, nuk zbatohet kur titullari i këtyre të drejtave ka dhënë vetë pëlqimin për

dhënien e informacionit përkatës ose kur në momentin e dhënies së informacionit ai është konsideruar autoritet publik në bazë të parashikimeve të këtij ligji. Pavarësisht nga sa parashikohet në këtë pikë, informacioni i kërkuar nuk refuzohet në rast se ekziston një interes publik më i lartë për dhënien e tij.

Përsa më lart, gjykojmë se është i mjaftueshëm informacioni i mësipërm dhe nuk mund tju vëmë në dispozicion dokumentacionin i cili bie ndesh me legjislacionin e sipër cituar në pikat a), b), c).

Për çdo informacion mbi procedurat e prokurimit, ju lutemi të drejtoheni pranë Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Ju faleminderit!

